



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, 28 tetor 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Syla, Mimoza Ahmetaj, Qamile Morina, Armend Zemaj, Bujar Bukoshi dhe Teuta Hadri.

Mungoi: Slllobodan Petroviq.

Nga Ministria e Shëndetësisë: Ilir Rrecaj – ushtrues detyre - sekretar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Haki Sfishta - drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Shëndetësisë.

Munguan: Përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati

Nga Zyra e Kryetarit: Nexhat Shatri

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale rreth planifikimit buxhetor për vitin 2009;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Gjynaze Syla – Propozoi që Komisioni në mbledhjen e radhës t'i ftojë për t'i dëgjuar përfaqësuesit e Trustit Pensional, si dhe ta realizojë një vizitë në Spitalin Rajonal të pjesën veriore të Mitrovicës.

Sadik Idriz – Tha se Komisioni do të diskutojë lidhur me këto propozime.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale rreth planifikimit buxhetor për vitin 2009

Sadik Idriz – Tha se takimi është organizuar me qëllim që Komisioni të ketë informata rreth planifikimit buxhetor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale për vitin 2009. Përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale edhe pse ishin të ftuar nuk iu kanë përgjigjur ftesës së Komisionit për takim. Shëndetësia në Kosovë ka probleme të mëdha. Buxheti është i pamjaftueshëm. Ka mungesë për fondin e sigurimeve shëndetësore, ndërsa Ligji për sigurime shëndetësore është duke u përgatitur. Hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Teuta Hadri – Tha se ka një vërejtje: Përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë është dashur paraprakisht t'ua dorëzonin një draft të planifikimit buxhetor anëtarëve të Komisionit, për ta analizuar, me qëllim që diskutimi në takim të jetë më konkret.

Ilir Rrecaj – Tha se në mënyrë elektronike do ta dorëzojnë draftin e buxhetit për vitin 2009. Fillimi i përpilimit të procesit për buxhetin 2009, këtë vit është vazhdimësi e aktiviteteve të Qeverisë. Planifikimi buxhetor është bazuar në Programin e zhvillimit të Qeverisë dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Këto dokumente janë përpiluar paralelisht. Është formuar një grup i punës që ka punuar në përputhshmëri me qarkoret buxhetore 1, 02 dhe 2A dhe pritet që drafti përfundimtar të jetë gati javën e ardhshme. Kriter kyç për miratimin e propozimeve për investime kapitale ka qenë që investimet nga vitet e kaluara të mos ndërpriten dhe të gjitha investimet kapitale të jenë në harmoni me Programin e Qeverisë për zhvillimin e Kosovës dhe me Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Do të thotë që të ketë vazhdimësi veprimi. Në mënyrë specifike për institucionet shëndetësore, përveç bazës, qëllimi ka qenë të sigurohen mjetet elementare për funksionimin e sistemit shëndetësorë, si: sigurimi i ujit të nxehtë, sigurimi i gazit dhe përmirësimi i infrastrukturës së ujësjellësit. Këto kanë qenë orientimet kyçe për dallim nga vitet e kaluara, kur kemi qenë të orientuar në sigurimin e pajisjeve diagnostike. Procesi i tenderimit për sigurimin e këtyre pajisjeve ka përfunduar. Sipas objektivës strategjike, që është në përpilim e sipër për zhvillimin sektorial, jemi bazuar në përmirësimin e menaxhimit dhe në reduktimin e morbiditetit dhe mortalitetit.

Haki Sfishta – Tha se Ministria e Shëndetësisë në sajë të konsultimeve u afrua më tepër me menaxherët e institucioneve për nevojat buxhetore të tyre dhe për problemet me të cilat ballafaqoheshin ata. Përfaqësuesit e Ministrisë i kanë vizituar edhe organizatat buxhetore lidhur me investimet, me theks të veçantë. Sugjerimi ka qenë për investimet kapitale që organizatat buxhetore planifikojnë t'i paraqesin për investime, të kenë projekt ideor shumë të hollësishëm, në mënyrë që të dihet çka dëshirojnë të investojnë.

Në kuadër të procesit buxhetorë në nivel të Qeverisë Ministrisa e Ekonomisë dhe e Financave i lëshoi tri qarkore buxhetore 1, 02 dhe 2A. Në Qarkoren 1 kanë qenë kufijtë buxhetorë për shpenzime operative, por jo edhe për shpenzime kapitale. Me qarkoren buxhetore 02 kanë qenë kufij të caktuar, mirëpo në ndërkohë Ministria e Shëndetësisë i ka paraqitur kërkesat e veta fillestare që dallohen dhe i tejkalojnë kufijtë e qarkores buxhetore. Këta kufij janë tejkalluar duke i pasur parasysh nevojat buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe për afërsisht këto nevoja janë 40 deri 45 % më të larta se kufijtë e përcaktuar - në kuadër të kategorisë mallra dhe shërbime. Disa organizata buxhetore kanë paraqitur kërkesa për shtim të numrit të punëtorëve, mirëpo në qarkoren buxhetore ka qenë qëndrim se numri i punëtorëve nuk ka mundësi të rritet. Në qarkoren buxhetore 2A përcaktohen kufijtë e fortë buxhetorë, që i cakton Qeveria. Ministria e Shëndetësisë në nivel total, sipas kategorive ekonomike, krahasuar me buxhetin e miratuar të vitit 2008 dhe me qarkoret e lëshuara tani, ka paraqitur një shtim të numrit të punëtorëve duke e respektuar një vendim të Qeverisë që parasheh 91 punëtorë shtesë. 16 punëtorët e shëndetit mendorë punojnë dhe paguhen nga një donacion norvegjez. Kontrata këtyre u skadon më 31 dhjetor 2008. Kemi paraqitur kërkesë për këtë numër të punëtorëve. Në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë programi farmaceutik merr pjesën dërmuese të shpenzimeve mallra dhe shërbime. Krahasuar me buxhetin e miratuar që ka qenë 11.6 milionë euro për programin farmaceutik, me planifikimin e buxhetit për vitin 2009 në kufij të fortë, janë 16.1 % domethënë e merr afër 40 % të buxhetit. Krahasuar me vitin 2008 buxheti nëpër spitale për vitin 2009 është paraparë të ketë një rritje shumë të vogël. Krahasuar me rishikimin buxhetor dhe me kufijtë e caktuar në qarkoren buxhetore, për kategorinë shpenzime komunale buxheti është më i vogël, ndërsa krahasuar me buxhetin e miratuar të vitit 2008 me qarkoren buxhetore, është i njëjtë, domethënë nuk ka rritje. Sa u përket subvencioneve ka pasur shtim 2 milionë, nga të cilët 1.5 milion ka qenë i ndarë për kërkesat nga viti 2003 - 2007, ndërsa për vitin 2008 janë ndarë 500 mijë euro. Nevojat për trajtim jashtë vendit janë shumë më të mëdha se 1 milion. Shpenzimet kapitale për vitin 2009, krahasuar me shpenzimet kapitale të vitit 2008 dhe të qarkores buxhetore 2A, janë më të larta 5%.

Sadik Idriz – Tha, në vitin 2006 buxheti i Ministrisë për të gjitha shkallët ka qenë 8 milionë - asnjëherë më shumë. Në vitin e kaluar kanë qenë 11.5 milionë. Në vitin 2007 kanë qenë të ndara 6 milionë. Tani ka shumë më shumë mjete. Për barnat nga lista esenciale janë planifikuar 16.1 milionë. Me ngritjet e tanishme gjendja po përmirësohet. Kërkoj informacione për pagat dhe mëditjet, nëse këto kategori janë përfshirë në planin buxhetor për vitin 2009. Si është përfshirë kategoria e kujdestarisë?

Nurishahe Hulaj – Parashtrori pyetjet: Sa është përqindja e realizuar e listës esenciale krahasuar me vitin 2007 dhe tani, meqenëse buxheti është shumë më i madh? A ka paraparë Ministria e Shëndetësisë mjete për zbatimin e ligjeve? A hyjnë në grupin e punëtorëve të përgjithshëm të shëndetësisë edhe punëtorët me kontrata në vepër? Sa janë kontrata në vepër dhe ç'vijë buxhetore kemi për to?

Teuta Hadri – Tha se 16 punëtorët e shëndetit mendorë, për të cilët Ministria e Shëndetësisë ka bërë kërkesë, pse janë pranuar kur buxheti ka qenë kështu problematik? Si është paraparë me këtë planifikim buxhetor çështja e pagave dhe e kujdestarive? Ajo kërkoj informata lidhur me përgjigjet që ministri i ka dhënë para Kuvendit për shtesat prej 44 eurosh të punëtorëve shëndetësorë. Në këtë muaj ato shtesa nuk kanë dalë. Kur do të bëhen këto pagesa?

Mimoza Ahmetaj – Tha se, sipas planifikimit buxhetor të Ministrisë së Shëndetësisë investimet kapitale janë orientuar për vazhdimin e projekteve të viteve të kaluara. Për cilat projekte konkretisht është fjala? Për QKUK-në janë planifikuar 2 milionë euro më shumë. Për cilën kategori do t'i ndani këto meje? Në vendimin e Qeverisë, përkatësisht të Ministrisë së Shëndetësisë, pika e shtatë thotë: *“Angazhim që nga janari 2009 të ketë ngritje të pagave për të gjithë të punësuarit në institucionet e Republikës së Kosovës”*. A frikësoheni se do të ketë përsëri greva në vitin e ardhshëm, duke i pasur

parasysh premtimet që janë dhënë nga Ministria? Ka zëra se lista esenciale duhet të shkurtrohet. Cili është mendimi juaj?

Gjynaze Syla – Parashtrori pyetje: Cilat janë prioritetet për vitin 2009 në bazë të këtij planifikimi buxhetor. Domethënë cilët objektiva Ministria e Shëndetësisë synon t'i arrijë? Kërkoj që të dhënat nga planifikimi buxhetor për të gjitha kategoritë, si: shpenzimet kapitale, mallra dhe shërbime dhe paga të prezantohen në përqindje. Me buxhetin për vitin 2009, a është planifikuar zbatimi i ligjit për sigurime shëndetësore? A është planifikuar rritja e pagave? Pse është rritur buxheti për trajtim jashtë vendit? Pse ndodh që puna e natës për një infermiere në Spitalin Rajonal të Gjilanit paguhet 1.80 euro, në Prishtinë 11 euro, ndërsa në Gjakovë 7 euro?

Ajo tha se indikator për ta vlerësuar planifikimin e buxhetit për trajtim jashtë vendit është dashur të merret sukcesi - sa kanë vdekur dhe sa janë shëruar e jo krahasimet buxhetore. Ku është sukcesi i trajtimit jashtë vendit?

Armend Zemaj – Tha se për shpenzime kapitale Ministria e Shëndetësisë për vitin 2009 ka planifikuar rritje 5.5%. A hyjnë në këtë shifër në vazhdimësi edhe ato nga viti i kaluar apo janë rritje të reja? Sa i përket rritjes së numrit të punëtorëve, pse nuk është përfshirë propozimi juaj për 16 punëtorët e qendrave të shëndetit mendorë në propozimin për 91 punëtorët e tjerë?

Rita Hajzeraj – Tha se dëshiron të ketë strategji konkrete për prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2009. Për listën e barnave esenciale për vitin 2009 janë paraparë 2 milionë më shumë. A keni parë rritje konkrete dhe realizim konkret të këtyre kërkesave nga lista esenciale e barnave? A keni paraparë që mjetet e planifikuara për trajtim jashtë vendit të përdoren për të krijuar kushte në Kosovë për trajtimin e këtyre pacientëve?

Qamile Morina – Tha se investimet kapitale tash e tutje janë pa një planifikim dhe pa arsyetim, pa ndonjë informacion të plotë për cilindo investim të vogël. Kemi investime kapitale, megaprojekte që na përcjellin shtatë - tetë vjet dhe gjërat nuk po lëvizin fare, p.sh. në kardiokirurgji. Ministria e Shëndetësisë e ka planifikuar rritjen e buxhetit për trajtim jashtë vendit. Në vitin 2008 buxheti për trajtim jashtë vendit ka qenë 2 milionë. Ministria e Shëndetësisë duhet të bëjë analizë të thellë se si do ta bëhet trajtimi jashtë vendit. Duhet të dalë me një propozimprogram se cilët pacientë mund të trajtohen në Kosovë, dhe si të bëhet edukimi i stafit në Prishtinë. Çfarë programi ka paraparë Ministria e Shëndetësisë për trajtimin jashtë vendit për vitin 2009? Sa është harxhuar në këtë vit për listën esenciale të barnave?

Illir Rrecaj – Tha se nevojat e Ministrisë së Shëndetësisë janë shumë më të mëdha se sa buxheti i miratuar. 16.1 milionë të listës esenciale të barnave të miratuar, që rishikohet në baza vjetore, është përafërsisht gjysma e nevojave për përmbushje të listës esenciale. 3 milionë janë shpenzimet vjetore vetëm për dializë nga e cila përfitojnë rreth 1000 pacientë. Listën esenciale e përpilojnë profesionistët e fushave të veçanta që asnjëherë nuk propozojnë të zvogëlohet kjo listë, por gjithmonë këmbëngulin të rritet, sepse sa më e vogël të jetë lista, mundësia e trajtimit spitalor është më e vogël. Në planifikimin buxhetor për vitin 2009 nuk është paraparë rritja pagave dhe e mëditjeve. Për shtesën 44 euro është duke u shqyrtuar mundësia të kryhet ky obligim. Obligime kemi marrë edhe për kujdesin parësor. Nga të hyrat vetjake, ku është paraparë të realizohet ky vendim, për një pjesë të institucioneve të kujdesit dytësor dhe tretësor ka mjete për muajin e parë, mirëpo njëherë është marrë vendimi të mos shfrytëzohen këto mjete, sepse duhet të ndryshohet memorandumi me Ministrinë e Financave. Kemi identifikuar se prej nga mund të transferohen mjetet shtesë edhe për dy muajt e tjerë. Për kujdestari janë ndarë 2 milionë e 400 mijë euro. Është udhëzimi administrativ që i definon kujdestarinë dhe ndërresën e natës. Dallimi ndërmjet ndërresës së natës dhe kujdestarisë duket në koeficient dhe jo gjithmonë respektohet.

Kardiokirurgjia është projekt që është bërë në bashkëpunim me spitalin e Milanos dhe me Qeverinë Italiane. Ka dalë tenderi, vlera e të cilit është 600 e 50 mijë euro. 1/3 e mjeteve do të përfundojë këtë vit, 2/3 do të përfundojë në vitin e ardhshëm, deri në qershor. Deri në shtator të vitit të ardhshëm kjo njësi do të funksionojë.

Flora Brovina – Pyeti, sa për qind nga lista esenciale e barnave do të realizohet në këtë vit? Pagat e punëtorëve nuk janë aspak inspiruese dhe kjo shprehet në cilësinë e punës. Çka mendoni të arrini me participimin që e keni paraparë? Si do të menaxhohen ato mjete?

Kuvendi i ka miratuar direktivat e zhvillimit të mijëvjeçarit dhe këtu shëndetësia zë vend të madh. Sa mjete keni ndarë për t'i realizuar këto direktiva?

Ilir Rrecaj – Ngritja e buxhetit për barna është paraparë të jetë 39.8 %. Me këtë do të ketë përmirësim krahasuar me vitin 2008.

Haki Sfishta – Tha se me këtë planifikim buxhetor dhe me këto qarkore buxhetore nuk është paraparë rritja e pagave. Secili sektor i ka specifikat e veta, se cilin e merr si indikator. Sektori për trajtim jashtë vendit mund t'i ketë të dhënat për përgjigjen e drejtpërdrejtë sa është suksesi i këtij sektori.

Pas diskutimeve të deputetëve dhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë për planifikimin buxhetor për vitin 2009, Komisioni e nxori këtë

Përfundim

- *Komisioni do ta presë draftin përfundimtar të planifikimit buxhetor të Ministrisë së Shëndetësisë.*
- *Komisioni do të angazhohet për këtë planifikim buxhetor, në kohën kur në Kuvend do të procedohet buxheti.*

4. Të ndryshme

Qamile Morina – Tha se grupi i punës që po merret me monitorimin e Ligjit për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi ka vazhduar me monitorimin e Ligjit. Do të dalë me raport dhe me rekomandime konkrete. Komisioni pastaj do të vendosë nëse do të organizojë dëgjim publik lidhur me këtë ligj.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz